

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Raportimi Financiar në
sektorin publik**

M1

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	<u>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga</u> ShKÇAK- PIKËT E DHËNA
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
Total	100	

Problemi 1

Kompania e transportit urban është një kompani e cila operon në industrinë e transportit. Në kohën e përgatitjes së Pasqyrave Financiare më 31 Dhjetor 2017 në Bilancin Vërtetues të saj figuronte edhe Llogaria Pezull me vlerë 739 në debi.

Më pas ishin gjetur gabimet e mëposhtme:

1. Shpenzimet e telefonisë në vlerë 2,160€ ishin harruar në Bilancin Vërtetues, pra nuk ishin përfshirë fare, ndërsa pjesa tjetër e regjistrimit ishte në rregull.
2. Totali i librit të blerjeve ishte postuar tek Blerjet si 5,621€ por shuma e saktë kishte qenë 5,126€. Vlera e saktë është bartur në Llogaritë e Pagueshme.
3. Blerjet e autobusëve të cilat ishin paguar me para të gatshme më 1 Shtator 2017 ishin regjistruar si Shpenzime të riparimeve dhe mirëmbajtjes në vlerë 12,000€. Kompania e transportit urban ka një politikë që zhvlerëson pasuritë me metodën drejtëvizore nga data e blerjes, me normë vjetore 5%.
4. Një faturë për shpenzimet e karburanteve në vlerë 610€ ishte hedhur në shportë duke mos u regjistruar në libra fare.
5. Zbritjet e pranuar në vlerë 463€ në Tetor 2017 ishin regjistruar si debi në Llogarinë e Zbritjeve të lejuara.
6. Shpenzimet e qirasë të paguara gjatë vitit në vlerë 2,450€ ishin regjistruar në Llogarinë e shpenzimeve të energjisë elektrike.

KËRKOHET:

- a) Përgatitni regjistrimet në ditar për të regjistruar dhe korigjuar transaksionet relevante, duke u bazuar në informatat e mësipërme për pasqyrat financiare të vitit që përfundon më 31 dhjetor 2017 të Kompanisë së transportit urban. **(15 pikë)**
- b) Përgatitni llogarinë pezull për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017. **(5 pikë)**

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e problemit - 1

- 1) Debi : Shpenzimet e telefonit 2,160€
Kredi: Llogaria Pezull 2,160€
- 2) Debi: Llogaria Pezull 495€
Kredi : Blerjet 495€
- 3) Debi: Autobusët 12,000€
Kredi : Shpenzimet e riparimit 12,000€
Debi: Shpenzimet e zhverësimit 200 €
Kredi: Zhvlerësimi i akumuluar 200€
- 4) Debi: Shpenzimet e karburantit 610€
Kredi: Paraja e gatshme 610€
- 5) Debi: Llogaria Pezull 926€
Kredi: Zbritjet e marra 463€
Kredi: Zbritjet e lejuara 463€
- 6) Debi: Shpenzimet e energjisë elektrike 2,450€
Kredi: Shpenzimet e qirasë 2,450€

Llogaria Pezull

S' 739	
495	2,160
926	

S'' 0

Problemi 2

Kompania Termokosi ka llogaritë si më poshtë:

Pasqyra e Pozitës Financiare më 31 dhjetor 2010

	2010	2009
	€'000	€'000
Pasuritë jo-qarkulluese		
Prona, Fabrika & Pajisjet	66,300	55,600
Kostot e Zhvillimit	4,360	200
Prona Investuese	20,200	20,000
Total Pasuritë jo-qarkulluese	<u>90,860</u>	<u>75,800</u>
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet	8,900	9,200
Të arkëtueshmet tregtare	14,320	12,300
Paraja e gatshme	2,130	-
Total Pasuritë qarkulluese	<u>25,350</u>	<u>21,500</u>
Total Pasuritë	<u>116,210</u>	<u>97,300</u>
Ekuiteti & Detyrimet		
Ekuiteti		
Kapitali Aksionar	72,000	60,000
Premia	9,600	8,000
Fitimet e mbajtura	2,620	590
Rezerva e Rivlerësimit	2,800	800
Total Ekuiteti	<u>87,020</u>	<u>69,390</u>
Detyrimet afatgjata		
Kredia Bankare	18,500	12,100
Total Detyrimet afatgjata	<u>18,500</u>	<u>12,100</u>
Detyrimet afatshkurtra		
Të pagueshmet tregtare	9,340	10,050
Overdrafti Bankar	-	4,560
Tatimi në Koroporata	1,350	1,200
Total Detyrimet afatshkurtra	<u>10,690</u>	<u>15,810</u>
Total Ekuiteti & Detyrimet	<u>116,210</u>	<u>97,300</u>

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2010

€'000

Të hyrat	23,400
Kosto e shitjes	(18,910)
Fitimi Bruto	4,490
Shpenzimet e shpërndarjes	(1,129)
Shpenzimet administrative	(891)
Shpenzimet e interesit	(450)
E ardhura nga investimet	<u>357</u>
Fitimi para tatimit	2,377
Shpenzimet e tatimit në Korporata	(297)
Fitimi për vitin	2,080

Shënime:

- i. Prona, Fabrika & Pajisjet me vlerë në libra prej 2,050,000€ ishte shitur për 1,800,000€.
- ii. Zhvlerësimi për vitin për Pronën, Fabrikën & Pajisjet ishte në vlerë prej 2,150,000€.
- iii. Dividendët e paguar gjatë vitit ishin €50,000.

KËRKOHET:

Përgatitni Pasqyrën e Rrjedhës së Parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2010.

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e problemit - 2

Pasqyra e Rrjedhës së Parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2010

Rrjedha e parasë nga Aktiviteti Operativ	€'000
Fitimi para tatimit	2,377
Rregullimet për:	
Zhvlerësimi	2,150
Humbja në shitjen e P.F.P.	250
Shpenzimet e interesit	450
Të ardhurat nga investimet	(357)
Rritja në të arkëtueshmet	(2,020)
Rritja në stoqe	300
Zvogëlimi në të pagueshmet	(710)
Keshi i gjeneruar nga operimet	2,440
Interesi i paguar	(450)
Tatimi i paguar	(147)
Rrjedha neto e parasë nga Aktiviteti Operativ	1,843
Rrjedha e parasë nga Aktiviteti Investues	
Blerja e Pronës, Fabrikës & Pajisjeve	(12,900)
Shitja e Pronës, Fabrikës & Pajisjeve	1,800
Shpenzimet e zhvillimit	(4,160)
Të ardhurat nga investimet	157
Rrjedha neto e parasë nga Aktiviteti Investues	15,103
Rrjedha e parasë nga Aktiviteti Financues	
Hyrje e parasë nga emetimi i aksioneve	13,600
Hyrje e parasë nga rritja e kredive bankare	6,400
Dividenda e paguar	(50)
Rrjedha neto e parasë nga Aktiviteti Financues	19,950
Rritja neto në kesh dhe ekuivalentë të keshit	6,690
Keshi dhe ekuivalentët e keshit në fillim të vitit Shënimi 1	(4,560)
Keshi dhe ekuivalentët e keshit në fund të vitit Shënimi 1	2,130

Shënimi 1	2010	2009
	€'000	€'000
Keshi në dorë dhe gjendjet në banka	2,130	-
Overdrafti bankar	-	(4,560)
Keshi dhe ekuivalentët e keshit	2,130	(4,560)

Problemi 3

Më poshtë është dhënë bilanci vërtetues për Kompaninë e menaxhimit të mbeturinave:

BILANCI VËRTETUES MË 31 MAJ 2016		
Përshkrimi i llogarive	Debi	Kredi
	€	€
Shitjet		138,078
Blerjet	82,350	
Shpenzimet e transportit	5,144	
Tërheqjet	7,800	
Qiraja dhe sigurimi	6,622	
Posta	3,001	
Marketingu	1,330	
Pagat	26,420	
Borxhet e këqija	877	
Lejimet për të arkëtueshmet		130
Llogaritë e arkëtueshme	12,120	
Llogaritë e pagueshme		6,471
Paraja në dorë	177	
Paraja në bankë	1,002	
Stoqet më 1 qershor 2015	11,927	
Pajisjet me kosto	58,000	
Zhvlerësimi i akumuluar		19,000
Kapitali		53,091
TOTAL	216,770	216,770

Informatat tjera shtesë janë në dispozicion:

1. Nuk është regjistruar fare një faturë e qirasë e cila i takon periudhës raportuese prej 210€.
2. Nuk janë korrigjuar parapagimet për 880€ (e gjithë shuma është përfshirë në shpenzime).
3. Shuma prej 2,211€ paraqet transportin për në kompani për blerjet e bëra.
4. Pajisjet zhvlerësohen me metodën drejtvizore me 15% në vit.
5. Lejimet për të arkëtueshmet duhet të rriten për 40€.
6. Stoqet në fund janë 13,551€.

KËRKOHET:

- a) Përgatitni pasqyrën e të ardhurave për vitin që përfundon më 31 maj 2016. **(10 pikë)**
- b) Përgatitni pasqyrën e pozicionit financiar më 31 maj 2016. **(10 pikë)**

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e problemit - 3

a) Pasqyra e të ardhurave

Kompania e menaxhimit të mbeturinave
Pasqyra e të ardhurave për vitin që përfundon më 31 maj 2016

	€	€
Shitjet		138,078
Stoqet në fillim	11,927	
Blerjet (LL1)	84,561	
Minus Stoqet në fund	13,551	
Kosto e mallrave të shitur		<u>82,937</u>
Fitimi bruto		55,141
Transporti prej kompanisë(LL2)		2,933
Qeraja dhe sigurimi (LL3)		5,952
Posta		3,001
Marketingu		1,330
Pagat		26,420
Borxhet e këqija		877
Zhvlerësimi (LL4)		8,700
Borxhet e dyshimta		<u>40</u>
Fitimi neto		5,888

b) Pasqyra e pozitës financiare

Kompania e menaxhimit të mbeturinave
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 maj 2016

	€	€
Pasuritë jo-qarkulluese		
Pajisjet (kosto)	58,000	
<u>Zhvlerësimi i akumuluar</u>	<u>27,700</u>	
Pajisjet (Vlera Neto në Libra)		30,300
Total Pasuritë jo-qarkulluese		<u>30,300</u>
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet		13,551
Llogaritë e arkëtueshme	12,120	
<u>Lejimet</u>	<u>170</u>	
Llogaritë e arkëtueshme neto		11,950
Parapagimet		880
Paraja e gatshme		1,179
Total Pasuritë qarkulluese		<u>27,560</u>
Total Pasuritë		57,860

Ekuiteti & Detyrimet

Ekuiteti

Kapitali më 01 qershor 2015	53,091
Fitimi i vitit	5,888
Tërheqjet	(7,800)
Total Ekuiteti	<u>51,179</u>

Detyrimet afatshkurtra

Llogaritë e pagueshme	6,471
Akrualet	210
Total Detyrimet afatshkurtra	<u>6,681</u>

Total Ekuiteti & Detyrimet **57,860**

Llogaritjet

1. Blerjet

	€
Nga bilanci vërtetues	82,350
Plus transporti për në kompani	<u>2,211</u>
	84,561

2. Transporti prej kompanisë: $5,144€ - 2,211€ = 2,933€$

3. Qiraja dhe sigurimi

	€
Nga BV	6,622
Plus akrualet	210
Minus parapagimet	<u>(880)</u>
	5,952

4. Shpenzimet e zhvlerësimit: $15\% - 58,000€ = 8,700€$

Problemi 4

Saldo në librin e llogarisë së kontrollit të llogarive të pagueshme në librin kryesor të NPH Iberlepenci është 48,395€. Totali i listës së tepricave në librin e llogarive personale [analitike] është 46,644€. Pasi kontrolloi regjistrimet, Zyrtari Kryesor Financiar i NPH Iberlepencit gjeti arsyet e mëposhtme për diferencat:

- i. Një çek me vlerë 4,300€ iu pagua plotësisht një furnitori për të shlyer një faturë me vlerë 4,320€. Zbritja ishte regjistruar në llogarinë personale [analitike], por nuk ishte regjistruar në librin kryesor.
- ii. Totali i librit ditor të të pagueshmeve për muajin qershor ishte mbledhur gabim dhe shuma ishte më e madhe se sa duhet për 90€.
- iii. Totali i çeqeve të lëshuara ndaj furnitorëve ishte 78,056€, por ishte bartur në llogarinë e kontrollit si 78,065€.
- iv. Një faturë me vlerë 459€ nuk ishte regjistruar fare në libra.
- v. Një tepricë kreditore prej 870€ në llogarinë e një furnitori ishte përfshirë në listë si një tepricë debitore prej 780€.

KËRKOHET:

- a) Tregoni librin e llogarisë së kontrollit të llogarive të pagueshme, përfshirë të gjitha hyrjet e duhura korrigjuese. **(7 pikë)**
Shënim: Ju duhet të përdorni një format i cili tregon qartazi nëse regjistrimet që duhet të bëhen janë regjistrime në debi apo në kredi
- b) Tregoni harmonizimin e listës së tepricave të llogarive personale me tepricën e librit të korrigjuar të llogarisë së kontrollit të llogarive të pagueshme. **(7 pikë)**
- c) Tregoni tepricën e të pagueshmeve që duhet të raportohet në bilancin e gjendjes së NPH Iberlepenci, duke treguar edhe mënyrën se si do të raportohet teprica. **(3 pikë)**
- d) Jepni tre arsye se pse kryhen harmonizimet e librave të të pagueshmeve. **(3 pikë)**

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e problemit - 4

a) Llogaria kontrolluese e llogarive të pagueshme:

Llogaria e pagueshme (L/P)			
(i) Zbritja e paregjistruar	20€	Saldo në fund e pakorrigjuar	48,395€
(ii) Mbledhja keq e librit	90€	(iii) Çeqet e lëshuara	9€
		(iv) Fatura e harruar	459€
		Saldo në fund e korrigjuar	48,753€

b) Harmonizimi i llogarisë kontrolluese të llogarive të pagueshme me listat individuale të të pagueshmeve:

Saldo në fund e pakorrigjuar e listës individuale të L/P	46,644€
iv) Fatura e paregjistruar	+ 459€
v) Eliminimi i tepricës së gabuar	+ 780€
v) Përfshirja e tepricës së duhur	+ 870€
Saldo në fund e korrigjuar	48,753€

c) Teprica që duhet të raportohet në bilancin e gjendjes të NPH Iberlepençi është teprica e korrigjuar e librit të llogarisë së kontrollit të llogarive të pagueshme me vlerë 48,753€. Një gjë e tillë duhet të raportohet si një detyrim afat-shkurtër.

d) Harmonizimi i librit të të pagueshmeve kryhet për arsyet e mëposhtme:

- për të identifikuar gabimet në regjistrat kontabël
- për të ofruar një shifër të korrigjuar që duhet të përfshihet në pasqyrat përfundimtare financiare
- për të llogaritur të dhënat që mungojnë nëse regjistrat nuk mbahen siç duhet

Problemi 4

Informacionet e mëposhtme janë nxjerrë nga regjistrimet e kontabilitetit të Komunës X më 31 Dhjetor:

	Kosto më 1 janar 2017	Zhvlërimi i akumuluar më 1 janar 2017
	€'000	€'000
Toka dhe Ndërtesat	1,700	200
Automjetet	223	113
Paisjet kompjuterike	200	110

Norma dhe metoda e zhvlërimit

- Ndërtesat: 2% me metodën drejtvizore (lineare)
- Automjetet: 20% me metodën drejtvizore (lineare)
- Paisjet kompjuterike: në te kaluarën janë zhvlëruar me 25% me metodën drejtvizore. Zyrtari Kryesor Financiar i Komunës ka vendosur që duke filluar nga 1 janar 2017, t'i zhvlëroj këto paisje 20% me metodën e saldove zbritëse (tepricat që reduktohen).

Infotmatat e mëposhtme shtesë i keni në dispozicion:

- Kosto e ndërtesave është 1,000,000€.
- Një automjet me kosto 15,000€ më 3 janar kishte Vlerë Neto në Libra (VNL) 8,000€, ishte pjesë e një këmbimi me një automjet tjetër me kosto 20,000€.
- Është politikë e kompanisë që pasuritë e blera t'i zhvlëroj komplet në vitin e blerjes, kurse nuk i ngarkon fare zhvlërim në vitin e shitjes.

KËRKOHET:

- Përgatitni regjistrimet në Librin e Madh (Konto T) për transaksionet e mësipërme më datën 31 Dhjetor 2017, duke paraqitur edhe kalkulimet për shpenzimet e zhvlërimit për vitin. **(15 pikë)**
- Tregoni shumat që do të paraqiten në Pasqyrën e Pozitës Financiare (Bilancin e Gjendjes) dhe shumën që do të dërgohet në Pasqyrën e të Ardhurave në fund të vitit. **(5 pikë)**

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e problemit - 5

a) Përgatitja e regjistrimeve në Librin Kryesor

Toka dhe Ndërtesat

Saldo në fillim	1,700,000€	
Saldo në fund	1,700,000€	

Zhvlerësimi i akumuluar - Ndërtesat

	Saldo në fillim	200,000€
	Zhvlerësimi i vitit (L1.1)	20,000€
	Saldo në fund	220,000€

Llogaritja 1.

Kosto e Ndërtesave $1,000,000€ \times 2\% = 20,000€$

Automjetet

Saldo në fillim	223,000€	Automjeti i shitur me këmbim	15,000€
Automjeti i blerë me këmbim	20,000€		
Saldo në fund	228,000€		

Zhvlerësimi i akumuluar - Automjetet

Zhvlerësimi i akumuluar i automjetit të shitur	7,000€	Saldo në fillim	113,000€
		Zhvlerësimi i vitit (L1.2)	45,600€
		Saldo në fund	151,600€

Llogaritja 2.

Kosto e Automjeteve $228,000€ \times 20\% = 45,600€$

Pajisjet kompjuterike

Saldo në fillim	200,000€	
Saldo në fund	200,000€	

Zhvlerësimi i akumuluar - Pajisjet kompjuterike

	Saldo në fillim	110,000€
	Zhvlerësimi i vitit (L1.3)	18,000€
	Saldo në fund	128,000€

Llogaritja 3.

Kosto Historike 200,000€

Zhvlerësimi i akumuluar 110,000€

VNL $90,000€ \times 20\% = 18,000€$

b) Ekstrakt nga Pasqyra e Pozitës Financiare dhe Pasqyrës së të Ardhurave

Ekstrakt nga Pasqyra e Pozitës Financiare më 31 dhjetor 2017

	Kosto	Zhvlerësimi i Akumuluar	Vlera Neto në Libra
Toka dhe Ndërtesa	1,700,000€	220,000€	1,480,000€
Automjetet	228,000€	151,600€	76,400€
Pajisjet komp.	200,000€	128,000€	72,000€

Ekstrakt nga Pasqyra e të Ardhurave për periudhën që përfundon më 31 dhjetor 2017

Shpenzimet e zhvlerësimit për Ndërtesen	20,000€
Shpenzimet e zhvlerësimit për Automjetet	45,600€
Shpenzimet e zhvlerësimit për Pajisjet kom.	18,000€